



Caritas Shqiptar
Albania



**TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE
NJË SKLLAVËRI E RE.**

EDHE NE MUND TA LUFTOJME!

- Tregtia e vajzave është thyerje e lirisë dhe e të drejtave të njeriut.

- Ajo ndodh atëherë kur vajzat **mashtrohen**, përse u përket qëllimeve të udhëtimit të tyre dhe **detyrohen** që të prostituohen.

U merren **dokumentet personale**, zyrtarisht nuk ekzistojnë, askush nuk e di nëse qëndrojnë në atë vend.

Mos lejo të jesh e mashtruar, ke mënyra si ta ndihmosh veten



* Ti je 14 dhe 24 vjeç?

* Pret me padurim që të kryesh studimet?

* Dëshiron të martohesh jashtë shtetit?

* Do t'i fitosh vetë paratë?

* Dëshiron të gjesh një punë që paguhet mirë?

* Mendon të shkosh në vend të huaj?

* Je e bindur se në vend të huaj, jeta është më e mirë dhe më e lehtë se në Shqipëri?

* Do të bësh diçka për të ndryshuar jetën?

* Do të udhëtosh, të shohësh gjëra të reja?

* Nëse je dakord me shumë prej këtyre pyetjeve, Atëherë mendon seriozisht të shkosh në vend të huaj.

* Mos lejo të jesh e mashtruar, ke mënyra si ta ndihmosh veten.

Rrugët kah vendi i huaj janë të shumta. Asnjëra prej tyre nuk është e lehtë, sidomos nëse je e re, dhe vjen prej një vendi si Shqipëria.

Nuk është gjithmonë ashtu siç mendojmë ne.

Cilën rrugë do të zgjedhësh ti? A do të të çojë ajo në vendin e vërtetë?

Është shumë e mundur që rezultati të jetë ky:

Quhem Dhurata. Jam 20 vjeç. Vij nga një qytet i vogël. Fillova të mendoj për të shkuar në një vend të huaj. Një ditë njoha një djalë që quhej Robert, i cili jetonte në Itali. Ai pas disa muajsh frekuentimi më propozoi që të martohesha me të, dhe unë pranova. Gjithçka zhvillohej shumë shpejt. Brenda pak ditëve më tha se më kishte nxjerrë pasaportën, dhe se kishte përgatitur gjithçka që më nevojitej. Madje, nuk më nevojiteshin as lekë për udhëtim. Ai më çoi në Itali, ku më kishte premtuar se do të më gjente një punë të mirë.

Më kujtohet se ishte natë...

Ëndrra ime u shndërrua në tmerr..

Në vend të agjencisë së premtuar unë përfundova në një bordello të lirë.

Pa identitet, e blerë dhe e shitur

Me fjalë të tjera, isha MALL!

**Isha pa para,
e rrahur dhe e
munduar,
pa dokumente,
e mbyllur dhe e
izoluar**



Në realitet qëndrimi i tyre është i paligjshëm.

Është mirë të dish se:

Pasaporta është dokument personal i cili i jepet shtetasit të Republikës së Shqipërisë për arsye udhëtimi dhe qëndrimi në vend të huaj, si edhe për kthimin në vendin e tij.

Pasaporta gjatë qëndrimit në vend të huaj shërben për identifikimin e personit si dhe për identifikimin e shtetësisë.

Viza është leje udhëtimi për të shkuar në një vend të huaj dhe ajo i lëshohet për një ose për shumë udhëtime, ndërsa kohëzgjatja e saj caktohet nga zyrat konsullore diplomatike e shtetit në Republikën e Shqipërisë.

Viza jepet me afat kohor e cila nuk mund të mund të jetë më e gjatë se afati kohor i pasaportës.

Lejen e udhëtimit e jep:

Konsullata Diplomatike e Republikës së Shqipërisë në vendet e huaja, shtetasve të Republikës së Shqipërisë, i cili në vend të huaj ka mbetur pa dokumente udhëtimi.

Mirë është të dihet!!!

Pasaporta!!

Viza!!



Kontratat për punë

Është e rëndësishme kontrata që bën për punë në një vend të huaj.

Duhet të jesh e kujdesshme kur bën kontratë pune. Kontrata e punës duhet të jetë në gjuhën tënde amtare dhe plotësisht e kuptueshme, para se të nënshkruhet.

Kontrata e punës duhet të përmbajë:
Vendin se ku duhet të punosh
Emrin e ndërmarrjes dhe personin përgjegjës
Kushtet e punës
Kohëzgjatjen e orarit të punës dhe pushimin

Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata duhet të nënshkruhet, vulosur, në dy kopje të njëjta, njërën prej të cilave e mban ti.

Mos e nënshkruaj kontratën nëse dyshon në vërtetësinë dhe ligjshmërinë e saj ose nëse kushtet e punës nuk të pëlqejnë.

Mos e nënshkruaj kontratën e punës me agjenci ose me ndërmarrje e cila nuk ka licencë për ndërmjetësimin për punë në një vend të huaj.

Që të jesh më e sigurt në lidhje me rregullsinë e kontratës, këshillohu me ndonjë **avokat, prind, organizatë joqeveritare ose me dikë tjetër.**

Për informacionet në lidhje me ligjshmërinë e agjencisë ose të ndërmarrjes, si dhe për marrëdhëniet e punës ligjore të shtetit ku do të shkosh, drejtohu **Ambasadës** (përfaqësisë konsullore diplomatike) të shtetit në Republikën e Shqipërisë.

Para se të udhëtosh jashtë shtetit, jepu të afërmve të tu këto të dhëna:

Kopje të pasaportës, vizës dhe kontratës së punës
Fotografinë tënde (të bërë sa më vonë)

Adresën dhe numrin e telefonit të ambasadës së Shqipërisë në vendin ku do të udhëtosh

Adresën dhe numrin e telefonit të vendit ku do të shkosh të jetosh dhe punosh.

Emrin dhe adresën e punëdhënësit

Adresën dhe numrin e telefonit të shoqeve apo të njohurve (nëse ke) në shtetin ku do të udhëtosh.

Çfarë duhet të marrësh me vete?

- * Adresat dhe numrat e telefonit të organizatave të grave.
- * Adresën dhe numrin e telefonit të konsullatës diplomatike të Shqipërisë në shtetin ku do të shkosh.
- * Adresën dhe numrin e telefonit të shoqeve, shokëve nëse i ke në shtetin ku do të shkosh.

Nëse të kanë mashtruar përsëri në kushtet e punës, nëse je viktimë e tregtisë së vajzave, **nuk duhet të mallëngjehesh, sepse ke mënyra të ndryshme si ta ndihmosh veten!**

1.- Kërko ndihmë policisë. Në vendet e Evropës perëndimore, policia është e informuar mbi tregtinë e vajzave.

Mund t'i drejtohesh edhe policëve rrugorë. Në vendet e Evropës qendrore dhe juglindore (Suedi, Poloni, Hungari, Serbi, Greqi, Bullgari, Turqi)... është mirë të shkosh në komisariatet e policisë dhe t'u shpjegosh se çfarë të ka ndodhur. Madje, edhe nëse ata nuk e kuptojnë që ti je viktimë e tregtisë së vajzave dhe prostitucionit të dhunshëm, policët janë të detyruar që të të ndihmojnë. Mund t'u thuash se ke frikë të dalësh nga komisariati policor. Kërkohu përkthyes dhe që të të ndihmojnë të lidhsh me Ambasadën Shqiptare në vendin ku ndodhesh.

2.- Drejtohu Ambasadës Shqiptare në vendin në të cilin ndodhesh. Ambasada ka për detyrë të të ndihmojë. Kërko mbrojtje dhe që të kontaktosh me familjen në Shqipëri.

Nëse nuk ke dokumente personale, Ambasada e Shqipërisë do të japë dokumentin me të cilin do mundesh të kthehesh ligjërisht në Shqipëri.

3.- Drejtohu organizatave që u ofrojnë ndihmë grave që janë viktimë të dhunës. Në shumë vende ka numra telefoni të veçantë për SOS, për ndihmën e femrave të cilat kanë qenë viktimë të dhunës. Mundohu të mbash mend numrin e telefonit, dhe në rastin e parë që mundesh të telefonosh. Disa organizata ofrojnë edhe vendqëndrim sekret, ku do të mund të qëndrosh derisa të vendosin se çfarë do të bëjnë më

Ti nuk je fajtorë

E drejta jote është të jesh e mbrojtur, jo e gjykuar për atë që të ka ndodhur.



CARITAS SHQIPTAR

Rr. Don Bosko Tiranë–Albania

Tel: 00355 4 230088/47

Fax: 00355 4 234327

E-mail: caritalbania@caritas.icc-al.org